



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 253, dt.18.12.2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 18.12.2015, pasi shqyrtoi kërkesën për licensim në fushën e restaurimit për *ing. Alfred Çoma*,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për pajisje me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë AP. “**Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës**”, me nënkategorinë AP/2, sipas rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” të *ing. Alfred Çoma*.
 2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, pajisjen e *ing. Alfred Çoma* me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë AP. “**Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës**”, me nënkategorinë AP/2.
 3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI